

INTERVISTË E GORAN SVILANOVIQIT, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT PËR BASHKËPUNIM RAJONAL

Svilanoviq: Është momenti i marrëveshjes

Sipas Goran Svilanoviqit, janë pjekur kushtet edhe në Beograd, edhe në Prishtinë që të arrihet marrëveshja, e cila do të niste normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, ai thotë se procesi do të jetë shumëvjeçar, ndërsa një marrëveshje për veriun e Kosovës thotë se do të ishte sukseasi më i madh i përfaqësueses Ashton dhe i Bashkimit Evropian

vijon nga ballina

Svilanoviq: Gjatë këtyre vjetëve (prej atëherë) nuk e kam përcjellë dhe aq shumë politikën. Mahitem, natyrisht. Qartazi, e shoh se është paksa e tensionuar. Kjo është përshtypja ime. E kam pasur rastin të bisedoj me kryetarin e qeverisë, me presidenten, përveç kësaj kam pasur biseda me një grup deputetësh, anëtarë të Komisionit për Punë të Jashtme, dhe në këtë takim që ishte organizuar nga ana e përfaqësuesit të posaçëm të Bashkimit Evropian për Kosovën, kisha rastin të bisedoj edhe me një mori njerëzish nga sektori i shoqërisë civile, medieve. Dhe natyrisht edhe me përfaqësuesit e institucioneve kryesore ndërkombëtare, siç janë EULEX-i, UNMIK-u, OSBE-ja dhe natyrisht pata një takim shumë të mirë me zotin Zhbogar.

KD: Por cila është ajo porosi, që ju mendoni se është më e rëndësishmja që e keni vërejtur nga të gjitha këto biseda?

Svilanoviq: E dini pse kam thënë se është pak e tensionuar. Bazuar në të gjitha këto bisedime mendoj se kjo gjë është e lidhur, natyrisht, me pritje të shumta që dialogu që po zhvillohet tash e sa kohë në nivel të dy kryeministrave të sjellë megjithatë njëfarë rezultati në një të ardhme të afërt dhe është pritje e përgjithshme që njëfarë e arriture më e madhe të shënohet sa më parë dhe besoj se prej këtu buron një lloj tensioni, të themi ashtu, i vogël. Nuk është shumë ndryshe edhe në Beograd, t’ju them. Është ngjashëm, sepse thjesht ekziston një përshtypje e përbashkët se ky po që është një moment i rëndësishëm, kur mund të arrihet një përparim edhe më i madh krahasuar me javët dhe muajt e fundit pasi dialogu tashmë po jep rezultate, bazuar në marrëveshjet e arritura. Rezultat i këtyre marrëveshjeve është se Kosova tashmë në masë të plotë është pjesëmarrëse në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal në të njëjtën mënyrë siç janë edhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë. Takimi që ne patëm ka kaluar në një atmosferë jashtëzakonisht të mirë, me shumë fjalë të mira falënderimi nga ana kosovare dhe mbështetjeje nga ana serbe, kështu që shumë mirë jemi pritur dhe përshëndetur nga të gjithë pjesëmarrësit. Kështu që mund të them se tanimë kemi disa rezultate. Kjo ka qenë në një mënyrë pjesa më e lehtë e punës.

Por njëkohësisht, kjo mundëson që unë të vij këtu si sekretar i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe të bisedoj me udhëheqësit kosovarë pikërisht për këtë, çfarë tani dhe si të shkohet tutje, cilat janë interesat, në cilat fusha Kosova sheh hapësirë dhe ku janë prioritetet. Po ashtu e kam pasur mundësinë që të them se cilat janë ato gjëra që mund të na presin në vitet e ardhshme, cilat janë planet dhe aty pikërisht shkojmë.

Synimet për vitin 2020

KD: Dhe cilat janë planet tuaja?

Svilanoviq: Ja, po ua shpjegoj. Do ta kemi takimin e radhës tani, më 25 prill, dhe pas asaj do të kemi edhe takimin tonë vjetor, në javën e fundit të muajit maj. Në këto dy takime, në fakt, do të duhej të miratohej strategjia jonë për disa vitet e ardhshme. Ne po e përgatisim strategjinë dhe shpresojmë që ta dorëzojmë një version përfundimtar. Çka është thelbësore për mua – kjo për çfarë fola unë dhe shpresoj

që edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme këtu në Kosovë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë marrin pjesë në punimet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në emër të Kosovës, janë prioritetet: Këshilli për Bashkëpunim Rajonal ka përgatitur diçka që ne e quajmë Strategji për Evropën Juglindore deri në vitin 2020, e cila është e bazuar në Bashkimin Evropian dhe paraqet një mënyrë të re të definimit të prioriteteve në bashkëpunimin rajonal. Më konkretisht, gjëja më e rëndësishme që ne dëshirojmë të arrijmë me këtë strategji dhe që është edhe thelbi i saj, është se do të ishte një strategji e zhvillimit që do të duhej të ndihmonte në hapjen e vendeve të reja të punës në rajon. Prej këtu, si prioritetet, definoheh zhvillimi ekonomik dhe social, energjia dhe infrastruktura, si dhe ajo që ne e quajmë avancimi i potencialit njerëzor - arsimimi. Këto janë tri prioritetet kryesore dhe këto janë ato që duhet pritur që në disa vitet e ardhshme të jenë hapat kryesorë në aspektin e bashkëpunimit rajonal. Pse e kam thënë, vetëm t’ju a shpjegoj, se kjo do të duhej të ishte strategji zhvillimi, por që njëkohësisht mbështetet në krijimin e vendeve të reja të punës.

Kjo strategji është rezultat i marrëveshjes që kanë arritur ministrat e Ekonomisë në Tiranë, në nëntor të vitit të kaluar. Ministrat nga rajoni aty vetë i kanë definuar ato qëllimet e tyre, çfarë duhet të arrijnë. Ishin 11 prioritetet rajonale dhe 77 kombëtare, siç ata i kanë definuar. Ne në fakt të gjithë strategjinë e kemi bërë ashtu që të ndihmojmë që këto prioritetet, këto qëllime të realizohen. Do t’ju them se cilat janë disa prej atyre qëllimeve. Punësimi mesatar në rajon është 60 %. Pra, 60 % janë të punësuar prej atyre që mund të punësohen. Qëllimi është që deri në vitin 2020 numri i të punësuarve të rritet në 65 %. Kjo është një. E dyta është Bruto Prodhimi Vendor, GDP. Në këtë moment, GDP në nivel të rajonit është 38 % prej asaj që është mesatarja e Bashkimit Evropian. Qëllimi është nëse mund ta rrisim këtë në 46 %, deri në vitin 2020. Ende do të jemi nën gjysmën e mesatares së BE-së. Këto janë shënime të rënda.

KD: Pra, për të arritur një nivel evropian rajonit do t’i duhen shumë më shumë vjet, dekada ndoshta?

Svilanoviq: Më duhet të jem pakëz cinik. Për këtë kam folur edhe në këtë tryezën e rrumbullakët organizuar nga EUSR këtu, në Prishtinë, dhe kam thënë se duket sikur disa procese negative që po ndodhin në Bashkimin Evropian në fakt po na ndihmojnë që më shpejt të arrijmë deri te kjo, meqë mesatarja evropiane e GDP-së po bie... Mirëpo, natyrisht, nuk bëhet fjalë për këtë gjë, por do të dëshiroja të shihja që të gjithë të ecim më shpejt përpara. Por, kriza i ka goditur jashtëzakonisht fort të gjithë.

KD: Sa mendoni se kjo marrëveshje, me të cilën është mundësuar që Kosova të jetë pjesë e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe marrëveshjet e ardhshme të mundshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, mund të ndihmojnë apo të pengojnë në rast se nuk ndodhin?

Svilanoviq: Mund t’ju them shumë haptas, unë natyrisht që bisedova me përfaqësuesit e qeverisë së Serbisë pak para ardhjes këtu dhe ata janë shumë të interesuar për përparimin e mëturjtëshëm të bashkëpunimit dhe tregtisë me Kosovën. Kjo natyrisht ka të bëjë

krejtësisht me marrëveshjen dhe dialogun politik që është ndërmjet tyre. Mirëpo kur bëhet fjalë për një rol në bashkëpunimin rajonal, ata janë jashtëzakonisht të interesuar. Kosova është një prej partnerëve më të rëndësishëm tregtar të Serbisë, për këtë ekziston një vetëdije e plotë në Beograd. Ekziston po ashtu një vetëdije e plotë se mund të avancohet shumë më shumë sikur edhe procesi politik të vazhdonte përparimin sikur deri tani, që marrëveshja politike të arrihet.

“Ky është momenti kur marrëveshja është e mundur”

KD: Mendoni se vërtet nuk do të pengonte ai konflikt, të them ashtu, apo mospatim rreth statusit të Kosovës, në avancimin e këtyre marrëdhënieve?

Svilanoviq: Po, t’ju them, unë nisem nga supozimi se do të ketë marrëveshje politike. Nuk e di nëse do të ndodhë më 2 prill, por ky është momenti kur marrëveshja është e mundur. Dhe po ju tregoj pse mendoj se është kështu. Në Serbi keni një qeveri stabile, themelet patriotike të së cilës janë faktikisht të pakontestueshme, gjë kjo që ka qenë një prej barrëve kryesore që i rëndonin qeveritë e mëparshme, të cilat sado që janë përpjekur, vazhdimisht kanë pasur presion nga opozita. Unë i çmoj përpjekjet që qeveria e mëparshme i ka bërë në këtë aspekt, mirëpo, megjithatë, ato ishin disa gjëra mbi të cilat thjesht nuk mund të kalohej. Kjo qeveri nuk e ka këtë barrë. Gjëja e dytë shumë e rëndësishme për qeverinë në këtë moment është fakti se me ato gjëra që ka bërë gjatë disa muajve të fundit kundër korrupsionit, ka arritur të mbledhë mbështetje shtesë të qytetarëve, pa marrë parasysh ngjyrën politike, secili e përkrah. Sepse njerëzit e kanë parë së pari se sa para janë vjedhur, dhe se ekzistojnë gabimet sistemore që dikush tani tenton t’i përmirësojë, dhe këtu përkrahje japin të gjithë.

Pra, e keni një situatë në të cilën duhet të merren vendime të vështira politike. Siç është e vështirë në Prishtinë, është e vështirë edhe në Beograd. Unë besoj se kjo u jep atyre forcën që të mund të shkojnë drejt marrëveshjes. Gjëja esenciale është që të ekzistojë vetëdija se si duhet bërë një gjë e tillë përbrenda qarkut të njerëzve që marrin vendime – kryetari i qeverisë, nënkryetari qeverisë, presidenti i shtetit dhe bashkëpunëtorët e tyre. Mendoj se ky është një ndryshim i rëndësishëm, në krahasim me qeverinë në të cilën isha unë. Te ne në atë kohë ka ekzistuar - flas për fillimvitet 2000 - dallimi rreth asaj nëse menjëherë duhej nisur në zgjidhjen e çështjes së marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës apo nëse duhet të merremi me diçka tjetër.

KD: Flisni për qeverinë në kohën e Zoran Gjingjiqit?

Svilanoviq: Po, ashtu është. Dhe Gjingjiqi kishte qëndrimin se me këtë çështje (Kosovën) duhet të merremi tani, sado e vështirë të jetë, derisa të gjithë të tjerët ishim atëbotë të mendimit se kishim prioritetet tjera - problemet me Tribunalin e Hagës, situatën e vështirë ekonomike, dhe izolimin e vendit – këto ishin prioritetet për ne. Kështu Gjingjiqi mbeti i vetmuar në këtë.

Kjo qeveri sot - dhe kjo është përshtypje imja nga bisedat me ata - është në fakt plotësisht e vetëdijshme se ky është momenti që disa

marrëveshje të arrihen, se këtë mund ta arrijnë, natyrisht, pres që në ditët në vijim të arrihen kompromise nga të dyja anët. Kjo nuk është një gjë e kryer dhe e dakorduar, është punë e pritjeve si nga njëra ashtu edhe nga ana tjetër, mirëpo ky është momenti kur pritet që disa marrëveshje megjithatë mund të arrihen.

Gjëja e dytë që do të dëshiroja ta thosha lidhur me këtë temë është se kjo marrëveshje, për të cilën tani flasim, nuk do t’i japë fund gjithçkaje. A do të jetë tani më 2 prill, apo një ditë tjetër, nuk është shumë me rëndësi. Nuk është pra ky fundi, këtë dua ta shpjegoj. Edhe kur bëhet fjalë për procesin e integrimit të Serbisë edhe kur bëhet fjalë për procesin e stabilizim - asocimit të cilin Kosova e pret gjatë këtij viti, po ashtu bazuar në këtë marrëveshje të mundshme, një mori procesesh do të jenë të shënuara në një masë të madhe nga kjo marrëveshje, që do të thotë se në atë proces të afrimit me BE-në, për të dyja palët, do të hyjnë elemente të kësaj marrëveshjeje me data konkrete se kur, cilat obligime duhen përmbushur. Prej këtij këndi marrëveshja është e lehtë nëse e shikoni në mënyrë të përgjithshme, për shkak se, në fakt, kur kjo mënyrë të arrihet, atëherë praktikisht në vitet që po vijnë, kohëzgjatja e procesit të anëtarësimit e njëkohësisht edhe procesi i realizimit të bisedimeve do të mbështeteshin në data. Nuk e di nëse ekziston vetëdije për këtë nga të dyja palët...

KD: Cili mendoni ju se është fundi i kësaj loje, ta quaj ashtu, cili do të jetë ai kushti i fundit, që krejt në fund do të duhet të përmbushet?

Svilanoviq: Ju po më pyesni nëse kjo është, nuk e di, pranimi i plotë i pavarësisë së Kosovës. Nuk e di. Nga bisedimet që i kam zhvilluar kohëve të fundit me zyrtarët në Prishtinë askush këtë gjë këtu nuk e ka përmendur. Përkundrazi. As që presin që diçka e tillë edhe të ndodhë. Ne tani flasim për gjëra konkrete, për atë se si të rregullohet jetesa, para së gjithash në veri të Kosovës, dhe në këtë fushë pikërisht dhe pritet që të ketë marrëveshje, e cila më pas do të mund të aplikohet me kohë.

E çështja se çfarë do të ndodhë pas disa vitesh, apo pak më shumë se pas disa vitesh, në këtë moment mund vetëm të ngarkojë marrëveshjen dhe këtë raund të bisedimeve që pason dhe mendoj se thjesht nuk do të duhej të mershëm me këtë, por me atë se si dhe nëse me këtë marrëveshje do të rregullohet jetesa në veri të Kosovës. Dhe këtu vijmë deri te momenti kyç. Pa marrë parasysh se si do të duket marrëveshja, është një çështje ajo se si kryetari i Qeverisë së Kosovës do t’ua paraqesë atë qytetarëve të vet dhe një çështje tjetër ajo se si kryetari i qeverisë së Serbisë do t’ua paraqesë ato qytetarëve të vet. Element i veçantë është se si do ta pranojnë këtë njerëzit në veri, për jetesën e të cilëve edhe bëhet fjalë.

KD: Prisi se do të ketë tensionime në veri, pas kësaj?

Svilanoviq: Të kuptohemi. Ata janë të frikësuar, nuk janë të sigurt se çfarë u vjen, unë i kuptoj plotësisht. Dhe është mirë si qeveria e Serbisë u qaset atyre...

KD: Por a nuk mendoni se ata do të duhej të ishin të përfshirë në këto bisedime?

Svilanoviq: Po ata janë të përf-

shirë. Ata janë të përfshirë. Unë kam komunikim të vazhdueshëm me ta dhe nëse e shikoni strukturën, zëvendës drejtori i zyrës se qeverisë serbe për Kosovë është njëri prej njerëzve që e udhëheq komunën në veri, pra kjo është një mënyrë për të përfshirë në këtë qark dhe është gjë e mirë që është bërë kështu, pa marrë parasysh dallimet politike, dallimet në mënyrën e kuptimit të procesit. Mendoj se gjëja kyç është pikërisht kjo, sepse kështu njerëzit janë drejtpërsëdrejti të përfshirë, e tash nëse pajtohen apo jo kjo mund të ndryshojë varësisht nga ajo se për çfarë arrihet dhe nëse arrihet marrëveshje. Kjo është një gjë e mirë. Kështu që ky është një element i rëndësishëm i asaj, pasi që në fund të fundit, këta njerëz duhet të jenë të sigurt se kanë një rreth në të cilin mund të jetojnë dhe të ndihen të sigurt me familjet e tyre.

Paralelet me Preshevën dhe raste të tjera nuk e lehtësojnë procesin Thaçi-Daçiq

KD: Në një rast keni thënë, nuk e di nëse mendoni sërish njëjtë, se pa marrë parasysh se cila është marrëveshja rreth veriut - dhe këtë e keni thënë në kohën para shpalljes së pavarësisë, më 2006 apo 2007, në kohën e procesit të Ahtisaarit - se duhet të kemi parasysh kjo do të jetë model apo do të merret si bazë mbi të cilën njerëzit edhe në Luginën e Preshevës, e madje edhe në Baçkë do të kërkojnë modalitete të reja të vetëqeverisjes. A mund të jetë kjo edhe më tutje mundësi?

Svilanoviq: Kur në raportet midis Serbisë dhe Kosovës përfshihet edhe ajo hapësirë, përshtypja ime është se një gjë e tillë nuk e lehtëson pozitën e asnjërës prej palëve bashkëbiseduese tani, kryeministrave të dy qeverive që ndodhen në bisedime. Kështu që besoj se nëse dikush tani do të thoshte “ta shohim se çfarë nënkupton një gjë e tillë për Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnjën”, dhe ju tani i përmendët disa pjesë të Serbisë...

KD: ... i përmenda, pasi që e kam lexuar ta keni thënë ju...

Svilanoviq: Mendoj se një gjë e tillë vetëm sa do t’i ngarkonte palët ngarkues, mendoj se vetëm do ta ngarkonte procesin, po qe se dikush, në një moment të caktuar, do të thoshte “të vizatojmë harta”...

KD: Por, një efekt i tillë është i mundur, pa marrë parasysh nëse do të flasin kryeministrat për një gjë të tillë, apo jo. Se mund të ndodhë që dikush në rajonin e Baçkës në Vojvodinë, apo në Luginë të Preshevës të thotë “pasi që paska asociacione apo bashkësi në veri...”

Svilanoviq: T’i përmendim nga një, së pari Vojvodinën. Siç i shoh unë negociatat, njera prej vërejtjeve kryesore që vjen në Beograd, në qeverinë serbe se për atë për të cilën po flitet kur bëhet fjalë për veriun (e Kosovës) është pakrahueshëm më pak seç është Vojvodina në Serbi. Kjo është e vërtetë dhe një gjë e tillë njëmend paraqet pengesë.

Dikush po e përmend Republikën Srpska (në Bosnje dhe Hercegovinë). Ne nuk kemi lidhje me Republika Srpskan, dhe një gjë e tillë vetëm ngarkon bisedimet, pasi që merret si arsye për presion në Beograd.

Dhe nuk jam i sigurt se kjo që po bëhet tani (rreth veriut dhe Kosovës) mund të jetë bazë për



Foto: Driton Paçarada

diçka për Vojvodinën.

E përmendët Preshevën. Unë mendoj se ajo që po ndodh atje është në duart e njerëzve që jetojnë atje. Fjala është për popullsinë shumicë shqiptare dhe kohët e fundit ka pasur mjaft tensione në lidhje me përmendoren dhe unë mendoj se atje do të jetë e nevojshme që qeveria e Serbisë të ulët me njerëzit që jetojnë atje, që drejtojnë atë komunë, që janë të zgjedhur nga qytetarët dhe të tejkalojnë atë që ka ndodhur këta muajt e kaluar. Për këtë kam folur edhe gjatë tubimit këtu, në Prishtinë, në mënyrë më të përgjithësuar, kur thashë se trashëgimia, që për Serbinë ka qenë dyfish më e rëndë, pasi që ka përfshirë pasojat e luftës dhe Kosovën, e ka vështirësuar në tërësi procesin e zhvillimit politik dhe ekonomik serb të trembëdhjetë vjetëve të kaluar. Mendoj se një gjë e tillë tani shihet dhe ekziston vetëdijesimi edhe te qytetarët, e jo vetëm te zyrtarët dhe politikanët. Thjesht tërë energjia ka qenë plotësisht e përqendruar - për shembull në qeverinë pjesë e së cilës kam qenë - në bashkëpunimin me Hagën, qeveria tjetër e ka pasur temën e Kosovës. Një gjë e tillë e ka lënë në hije çështjen e punësimit dhe kështu me radhë. Kështu një gjë e tillë njëmend ka ngadalësuar zhvillimin në Serbi. Mendoj se tani edhe njerëzit në qeverinë e Serbisë nuk duan që kur herën tjetër të shkojnë në Paris, Washington, Bruksel apo Londër dhe duan të flasin për investimet, atyre t'u thuhet "prisi, e çfarë është bërë në lidhje me Kosovën". Mendoj se ata duan që tani të jenë në gjendje që të kenë një marrëveshje, e cila në të vërtetë do të zbatohet vitet e ardhshme, kjo për të cilën po flas nuk përfundon më 2 prill, pasi që është një proces që zgjat, por që do të mundësojë që biseda e radhës që Serbia do ta ketë me ndonjë shtet në botë të jetë bisedë për çështjet tjera jetësore.

KD: Po t'ju kishte thënë dikush gjatë kohës sa keni qenë ministër i Punëve të Jashtme se ky problem do të zgjidhet nga këta njerëz që janë në pushtet në Serbi, si do t'i ishit përgjigjur?

Svilanović: T'ju them troç, po të ma kishin thënë këtë gjë para një viti, e jo gjatë kohës sa kam qenë ministër, do të isha skeptik. Unë e çmoj guximin dhe atë që kanë bërë deri më tani dhe mendoj se këtë gjë janë duke e parë edhe në Prishtinë, bashkëbiseduesit e mi me të cilët kam folur gjatë ditëve të kaluara, po ashtu e kanë shprehur respektin për atë që është bërë muajt e fundit, natyrisht me pritjen që procesi të vazhdojë.

Zbatimi i marrëveshjeve – pjesë e obligimeve të palëve ndaj BE-së

KD: Flitet se procesi do të zbatohet edhe për arritjen e marrëveshjeve të tjera, të cilat janë të nevojshme dhe të pashmangshme. Sa mendoni se ekziston energjia dhe vullneti nga ana e Bashkimit Evropian, apo të them më mirë të përfaqësueses aktuale të lartë dhe ekipit të saj që edhe pas 2 prillit, apo çfarëdo date, të mbahet ai nivel i lartë i presionit, të them ashtu, pa të cilin mendoj se nuk do të kishte pasur sukses?

Svilanović: Marrëveshja e dy qeverive, e dy kryeministrave, për të cilën gjë besoj se ekziston hapësira, fuqia dhe vendosmëria, mendoj se paraqet mundësi për sukses të shërbimit të BE-së për politikë të jashtme. Mendoj se zonja Ashton dhe ekipi i saj kanë investuar shumë mund deri më tani dhe kanë pritur të mëdha që gjatë ditëve dhe javëve në vijim do të arrihet marrëveshje e kënaqshme për të gjithë, një marrëveshje kjo që do të paraqiste sukses, pasi që ky do të ishte kulmi i karrierës së tyre politike. Dhe jo vetëm karrierës së tyre politike, por një gjë e tillë do të konfirmonte vlerat e një sistemi të Bashkimit Evropian.

KD: Por, unë pyes – të shprehem ashtu – sa do të mbajë ujin kjo gjë, kur të largohen mjeshtrit?

Svilanović: Ky është elementi i dytë. i pari pra është se ky do të jetë sukcesi i tyre më i madh dhe besoj se Bashkimi Evropian do të duhet t'i falënderohet edhe Serbisë e edhe Kosovës, do të duhet t'i falënderohet mbështetjes së të tjerëve, të amerikanëve po ashtu, që kanë qenë pjesë e rëndësishme e këtij procesi, ndonëse jo në mënyrë direkte.

Sa i përket procesit për të cilin kam folur unë dhe për të cilin kam thënë se duhet të shikohet në një aspekt afatgjatë, si proces i anëtarësimit edhe të Serbisë dhe edhe të Kosovës, që do të ketë elemente të rëndësishme, jo vetëm të sundimit të ligjit, jo vetëm të zhvillimit ekonomik, jo vetëm reformë të arsimimit, por edhe të zbatimit të marrëveshjeve - kjo shndërrohet në automatizëm, dhe kjo nuk është më punë e zonjës Ashton. Kjo do të jetë punë e atyre që e udhëheqin procesin e anëtarësimit dhe unë mendoj se faktikisht prej momentit që arrihet marrëveshja, atëherë nuk është më çështje e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, por bëhet çështje e procesit të anëtarësimit. Ky është një proces tjetër që ka rregullat e veta dhe ato rregulla janë të njohura për të gjithë në rajon.

KD: Ta përfundojmë intervistën me institucionin që e udhëhoqi ju. Cili do të jetë roli i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në atë periudhë atëherë? Apo si mund të ndihmojë Këshilli si një vend për të gjithë?

Svilanović: Shumë faleminderit për këtë pyetje, sepse, kur shikoni dokumentet kur u themelua Këshilli për Bashkëpunim Rajonal si vazhdim i Paktit të Stabilitetit, misioni ka qenë i qartë dhe është përmbledhur përmes një fjalie. Misioni i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal që përmes avancimit të bashkëpunimit rajonal të kontribuojë në procesin e integritimeve evropiane dhe euroatlantike të të gjithëve në rajon. Kjo është puna jonë. Të gjitha ato për të cilat kam folur unë gjatë tryezës, si bashkëpunimi ekonomik, ato janë elemente të strategjisë sonë. Por, misioni ynë, në përkthim do të thotë se kur të arrihet marrëveshja, ne përmes strategjisë sonë, do të mundohemi të kontribuojmë jo vetëm në avancimin e raporteve Kosovë-Serbi, por edhe të gjithëve në rajon, për t'u lehtësuar atë që ata janë duke e negociuar, jo me neve, por me Bashkimin Evropian dhe kjo është gjëja që mund të pritet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal gjatë viteve në vijim. Pritjet e mia janë se një pjesë e madhe e procesit, që tani është duke u udhëhequr nga Drejtoria për Anëtarësim me kohë duhet që t'i bartet Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Si e dini kriza është duke u ndier kudo dhe është e pranishme në hapësirën e gjerë evropiane dhe është duke u folur se si duhet organizuar sistemi i Bashkimit Evropian dhe si një pjesë të detyrave tjera t'u bartet tjerëve. Disa prej punëve që kanë të bëjnë me procesin e anëtarësimit tashmë na janë bartur, por ato që kanë të bëjnë me bashkëpunimin tejkufitar, bashkëpunimin rajonal në këto fusha të ndryshme, të cilat i kam përmendur unë, ato me kohë do të kalojnë në Këshilli. Pra kjo që po e bëjmë është vazhdimësi e një procesi, në të cilin gjithnjë e më shumë rol do të ketë vetë Këshilli për Bashkëpunim Rajonal.

KD: Kjo do të thotë se do t'ju shohim gjithnjë e më shpesh këtu?

Svilanović: Shpresoj se ashtu do të jetë, për shkak se pikërisht tani është duke u negociuar për një sistem të ri të financimit të rajonit. Fjala është për Instrumentin e Para-Anëtarësimit (IPA) dhe ky lloj i dytë për të cilin është duke u folur, IPA2 dhe që duhet të vlejë prej vitit 2014 deri më 2020. Në këtë dokument të cilin e kemi përgatitur, tashmë është cekur në disa pika se Këshilli për

Goran Svilanović: "Kosova është një prej partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të Serbisë, për këtë ekziston një vetëdije e plotë në Beograd"

Bashkëpunim Rajonal do ta ketë rolin vendimtar kur është fjala për mjetet që kanë të bëjnë me IPA2. Kjo do të thotë se ne së bashku me të gjithë ata që janë të ulur në tavolinë do të merremi vesh se ku do të shkojnë ato mjete, të cilat kanë të bëjnë jo me pjesën shtetërore të IPA-s, por atë për bashkëpunim rajonal, pra është një pjesë e dytë e mjeteve që ia kanë ndarë rajonit, kështu që ky është një nga ata hapa të mëdhenj që pritet të vijnë. Gjëja që tani është e rëndësishme për ne është që të dëgjohet mirë zëri i rajonit, që shtetet të mund të thonë se ne jemi këtu. IPA2 në mënyrë se si është dizajnuar dhe në mënyrë në të cilën po negociohet në masë të madhe është IPA për zhvillim. Bashkimi Evropian dëshiron që përmes atyre mjeteve t'u ndihmojë shteteve që ndodhen në procesin e bashkimit për të tejkuluar pasojat e krizës. Është e evidente se një gjë e tillë paraqet prioritet. Pastaj është gjëja që deri më tani ka qenë prioritet dhe që ka të bëjë me miratimin e bazës ligjore evropiane.

KD: Në përgjithësi, tingëlloni optimist.

Svilanović: Unë jam optimist. E dini si... për disa procese duhet kohë, t'i kthehemi bisedës sonë më parë që kishte të bënte me vitet 2005, 2006. Edhe unë me kënaqësi të madhe jam duke e përcjellë këtë fazë vendimtare të bisedimeve Serbi-Kosovë, në arritjen e një marrëveshjeje e cila do t'u mundësonte të gjithëve të jetojnë dhe të punojnë pa ngarkesa në këto hapësira. Pra këta tetë vjet kanë qenë të nevojshëm që disa gjëra të kuptohen, që njerëzit të vijnë në një pikë që ta pranojnë një politikë. Mua më duket se kjo është gjëja që më bën optimist, pasi që politika jeton, pra ideja se si mund të zhvillohet një gjë, pa marrë parasysh se a është një apo një qeveri tjetër në Serbi apo Kosovë. Ajo që e ka treguar kjo qeveri në Serbi është se dëshiron të luftojë me pasojat e krizës, se dëshiron të luftojë me pasojat e keq-qeverisjes që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe se e do rrugën që të shpie drejt Bashkimit Evropian. Për këtë gjë nuk ka fare dilemë. Politika jeton, pa marrë parasysh nëse ndërrohen qeveritë dhe dikush tjetër bëhet pjesë e njërës apo qeverisë tjetër. Kjo më bën të mendoj se politika zgjat dhe se ajo e ka bazën e fortë.

KD: Mendoni se tani ka ardhur koha?

Svilanović: Mendoj se për disa vendime të vështira duhet kohë dhe unë shpresoj se tani, përveç kohës, e cila ka kaluar, ka mjaft edhe guxim.

SHKURT

Deda: Në bisedime as Kosova, as Serbia nuk fitojnë

BEOGRAD, 1 PRILL - Drejtori i Institutit Kosovar për Hulumtime Politike dhe Zhvillim-KIPRED, Ilir Deda, ka thënë se në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të ketë fitues dhe të dyja palët do të detyrohen të bëjnë kompromise.

"As Kosova, as Serbia nuk do të fitojnë. Veriu do të mbetet në Kosovë, kurse për kundërshtpërbllim do të formojë Asociacionin e komunave serbe me kompetenca më të buta apo pak më të forta. Disa sigurisht se do të mllëfosen, e disa do të jenë të lumtur që më në fund u zgjidh problemi dhe që të gjithë t'i kthehemi jetës, zhvillimit të shoqërisë", ka thënë Deda për gazetën "Danas".

I pyetur nëse Qeveria e Kosovës nën udhëheqjen e Hashim Thaçit do të ketë fuqi të zbatojë marrëveshjet, Deda ka thënë se Qeveria e Kosovës është e varur nga përkrahja ndërkom-bëtare, prandaj do të zbatojë gjithçka që duhet. (koha.net)

Asanaj u vetëvra, por hetimet mund të rihapen

Prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Blerim Isufaj, ka thënë se rasti "Dino Asanaj" është mbyllur me konstatimin si vetëvrasje, kurse për rastin "Hamdi Sopa" nuk ka dashur të fliste shumë. Isufaj ka lënë të hapur mundësinë për të hapur sërish hetime në rastin "Dino Asanaj", nëse gjenden prova të reja që dëshmojnë të kundërtën.

Ndërkaq, për rastin e Hamdi Sopës, duke folur në emisionin "Puls" të KTV-së, prokurori Isufaj nuk ka dashur të fliste, duke thënë se është rast nën hetime dhe se shumë shpejt do të përfundojnë hetimet.

Eksperti i mjekësisë ligjore, Arsim Gërxhaliu, ka thënë se i ndjeri Dino Asanaj kishte 11 plagë dhe sipas tij është vërtetuar se ato plagë janë shkakuar nga vetë Dino Asanaj, transmeton ORAinfo. Ndërsa psikiatri Isuf Ulaj ka thënë se i ndjeri nuk ka pasur histori të trajtimit psikiatrik. (Telegrafi)

WSJ-ja parashikon përkeqësim në veri nëse dështon dialogu

NEW YORK, 1 PRILL - Dështimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të çojë në përkeqësimin e kushteve në veri të Kosovës, shkruan gazeta amerikane "Wall Street Journal", duke cituar paralajmërimet e diplomatëve, transmeton Radio Evropa e Lirë.

Në artikullin që paralajmëron rrethin e nesërm të bisedimeve ndërmjet kryeministrave Hashim Thaçi dhe Ivica Daçiç, gazeta shkruan se "udhëheqësit e Kosovës dhe ata të Serbisë takohen për t'u marrë vesh rreth kushteve të marrëveshjes, e cila, me kohë, mund të ndryshojë raportet midis dy fqinjëve ballkanikë dhe të shërojë plagët që datojnë që nga rënia e Jugosllavisë".

Në mesin e çështjeve të hapura në bisedimet Thaçi-Daçiç janë kompetencat që do t'i kishte asociacioni i komunave serbe në Kosovë.

Beogradi do kontrollin e gjyqësisë, policisë dhe të planifikimit hapësinoz, por Prishtina kundërshton fuqishëm.